



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 130 Prot

Tiranë, më 12.04 2014

VENDIM Nr. 302, dt. 18.04.2014

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 18.04.2014, mbasi shqyrtoi "Variantin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për zonën e mbrojtur përreth "Shpellës së Letmit", rrethi Librazhd, në kuadër të miratimit të lejes arkeologjike për projektin: Ndërtimi i hidrocentraleve mbi Lumin Zalli i Qarrishtes, Rrethi Librazhd - mbi bazën e kërkesës së Subjektit "GIZAVESHT ENERGY ALBANIA" sh.p.k.,

VENDOSI:

- I. Të ndryshohet projekti i zbatimit për të reflektuar spostimin jashtë zonës së mbrojtur të monumentit "Shpella e Letmit", të gjurmës së tubacionit të presionit, në një distancë prej 145 m.
- II. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të përcaktojë përmasat e zonës së mbrojtur rreth Monumentit të Kategorisë së I "Shpella e Letmit".
- III. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: Ndërtimi i hidrocentraleve mbi Lumin Zalli i Qarrishtes, Rrethi Librazhd - "GIZAVESHT ENERGY ALBANIA" sh.p.k.
- IV. Të lidhet kontrata dypalëshe midis Subjektit "GIZAVESHT ENERGY ALBANIA" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik ku të përcaktohen në mënyrë të detajuar detyrimet e palëve.
- V. Informacioni mbi ecurinë e punimeve të paraqitet në mënyrë periodike pranë Sekretarisë Teknike të KKA.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
ARTAN PUTO



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, Nr. 76, ish Kinostudio

Tiranë, Shqipëri,

Tel/Fax: 04 2272171

www.asha.gov.al